



RAPORT

Mbi publikimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në faqen Zyrtare Web, rrjetet sociale të Facebook dhe Instagram, për periudhën Shtator – Tetor 2021

Ky Raport synon të pasqyrojë një përmbledhje të aktiviteteve të zhvilluara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas përgjatë muajve Shtator – Tetor 2021. Aktivitetet konsistojnë kryesisht në: takime të ndryshme të zhvilluara në nivel ndërinstitutional, takime të zhvilluara me institucione në nivel rajonal, fushtata ndërgjegjësimi në qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, si dhe trajnime të zhvilluara me qëllim forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimit.

**Klejda Poçi, Koordinator për të Drejtën e Informimit
Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas**

Contents

1. Hyrje2

1. Takimet e zhvilluara nga DNJF në nivel ndërinstitucional

- 1.1 Takim me përfaqësuesit e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.....
- 1.2 Takim në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.....

2. Takimet e zhvilluara nga DNJF në bashkëpunim me institucionet në nivel rajonal

- 2.1 Takim me institucionet shtetërore në qytetin e Shkodrës.....
- 2.2 Takim me institucionet shtetërore në qytetin e Lezhës.....
- 2.3 Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore Gjirokastrë, pranë Bashkisë Gjirokastrë.....
- 2.4 Bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Mekanizmin e Koordinuar të Referimit Kundër Dhunës në Familje me qëllim zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.....
- 2.5 Vijn bashkëpunimi i frytshëm Ministrisë së Drejtësisë/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) për sigurimin e shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.....
- 2.6 Takim në qytetin e Pogradecit.....

3. Fushata ndërgjegjësimi

- 3.1 Aktivitet ndërgjegjëses pranë Qendrës Sociale Multidisiplinare
- 3.2 Takim “Situata e Romëve në Bashkinë Lushnjë”.....
- 3.3 Takim i hapur pranë komunitetit rom dhe egjiptian në Gjirokastrë.....
- 3.4 Aktivitet ndërgjegjëses pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.....
- 3.5 Ndihma juridike falas në qytetin e Pogradecit.....

4. Trajnime të zhvilluara për ofruesit e shërbimit

- 4.1 Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në rrethe.....
- 4.2 Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë.....
- 4.3 Trajnim i paraligjorëve të angazhuar.....

5. Marrëveshje Bashkëpunimi

- 5.1 Marrëveshje Bashkëpunimi me Shoqatën “Invalidët E Punës Shqipëri”.....
- 5.2 Bashkëpunim me Shoqatën Para-Tetraplegjikë, Dega Shkodër.....
- 5.3 Fokus i shtuar për kategoritë romë dhe egjiptiane përmes nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit me Organizatën “Drejtësi Sociale”.....

6. Regjitrimi i Markës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

7. Monitorimi i Vazhdueshëm, Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Pogradec

Hyrje

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë efikente dhe efektive.

Ligji nr.111/2017, “*Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti*”, ka si qëllim të sigurojë akses të barabartë në drejtësi përmes garantimit dhe funksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Ky sistem garanton ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efikente dhe efektive.

Në këtë ligj, përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas¹, disa prej të cilave janë: mbledhja dhe analiza e informacionit mbi dhënien e ndihmës juridike dhe **organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj; bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare, me Klinika Ligjore dhe me Organizata Jofitimprurëse dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, **nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.****

Këto dy detyra të Drejtorisë tregojnë qartë se **fushatat e ndërgjegjësimit, informimi i publikut** mbi sistemin e ndihmës juridike, kushtet për përfitimin e saj si dhe bashkëpunimi me aktorët kryesorë të përcaktuar në ligj për ofrimin e ndihmës juridike, janë jo vetëm detyra funksionale të përcaktuara me ligj por edhe pjesë përbërëse e misionit të drejtorisë në funksion të mirëadministrimit/mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas.

Thënë këtë, fushëveprimtaria e DNJF-së është ngushtësisht e lidhur me informimin dhe edukimin ligjor të publikut e rrjedhimisht lidhet dhe me Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-23.

¹ Bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 111/2017, “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, DNJF krahas të gjithë detyrave të tjera, është përgjegjëse për:

- Organizimin e fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj;
- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.

1.TAKIMET E ZHVILLUARA NGA DNJF NË NIVEL NDËRINSTITUCIONAL

1.1 Takim me përfaqësuesit e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Më datë 4 Tetor 2021, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Departamentit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut, pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, takim në funksion të garantimit të aksesit në drejtësi për kategoritë vulnerabël në Republikën e Shqipërisë si një qëllim i përbashkët,

Më konkretisht gjatë këtij takimi u *bë me dije mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike* të garantuar nga shteti dhe *u bisedua mbi mundësitë e bashkëpunimit* në funksion të promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruesve të shërbimit si dhe rritjes së kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike apo asistencës tekniko-ligjore për përmirësimin e ligjit/akteve nënligjore në fuqi.

Ky takim shërbeu si një hap i parë në koordinimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të ndërsjellta, në rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi.

1.2 Takim në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

Më datë 24 Shtator 2021, u zhvillua takimi i grupit teknik të zbatimit të Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, për periudhën Janar – Qershor 2021.

Gjatë këtij takimi, u diskutua në terma teknikë mbi përmbajtjen e raportit të monitorimit për gjashtëmujorin e parë të vitit. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si një ndër institucionet e varësisë të Ministrit të Drejtësisë është e angazhuar në këtë strategji me përgjegjësinë për hartimin dhe miratimin e Planit të Integritetit për institucionin, si një detyrim që rrjedh nga objektivat A.8 dhe A.9 të Strategjisë Antikorrupsion.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka nisur punën për hartimin e këtij dokumenti strategjik dhe parashikon miratimin e tij në fund të vitit 2021.

2. TAKIMET E ZHVILLUARA NGA DNJF NË BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET NË NIVEL RAJONAL

2.1 Takim me institucionet shtetërore në qytetin e Shkodrës

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvilloi një takim në qytetin e Shkodrës me përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore pranë Bashkisë Shkodër dhe përfaqësues të OJF-ve të cilat operojnë në këtë qytet.

Në këtë takim u diskutua mbi Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër, veprimtarinë e kësaj qendre dhe rezultatet e arritura deri tani.

U diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit nëpërmjet institucioneve shtetërore dhe jo vetëm.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas gjen rastin të falenderojë të gjithë pjesëmarrësit për bashkëpunimin e frytshëm.

2.2 Takim me institucionet shtetërore në qytetin e Lezhës

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvilloi një takim në qytetin e Lezhës me përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore pranë Bashkisë Lezhë dhe përfaqësues të OJF-ve të cilat operojnë në këtë qytet.

Ky takim kishte në vëmendje rezultatet e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë dhe bashkëpunimin me aktorët e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

U diskutua mbi vendosjen e urave të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe u dakordësua referimi i rasteve për ndihmë juridike pranë Qendrës.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas gjen rastin të falenderojë të gjithë pjesëmarrësit për bashkëpunimin e frytshëm.

2.3 Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore Gjirokastër, pranë Bashkisë Gjirokastër

U zhvillua në qytetin e Gjirokastrës takimi midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, punonjëseve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër dhe përfaqësuesve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore pranë Bashkisë Gjirokastër.

Në këtë takim morën pjesë funksionarë të cilët në fokus të veprimtarisë së tyre kishin kategoritë e veçanta të cilat janë pjesë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Në takim u diskutua mbi vendosjen e urave të bashkëpunimit ndërinstitutional, mbi rezultatet e bashkëpunimit të këtij institucioni me Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër dhe u dakordësua referimi i rasteve për ndihmë juridike pranë Qendrës.

Në vijim të konkretizimit të këtij bashkëpunimi të frytshëm, u firmos një marrëveshje mirëkuptimi midis Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore Gjirokastër.

2.4 Bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Mekanizmin e Koordinuar të Referimit Kundër Dhunës në Familje me qëllim zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta

Paraligjorët e angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë, po vijnë me bashkëpunimin me insitucionet qendore/vendore në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjëse/edukimit ligjor të publikut.

Në kuadër të kësaj nisme, paraligjorët, më datë **07.09.2021**, zhvilluan një takim me përfaqësues të **Bashkisë Tiranë** si dhe me **Koordinatorin Vendore kundër Dhunës në Familje**, zj. Anjeza Bojaxhiu, me qëllim ngritjen e urave të bashkëpunimit.

Gjatë këtij takimi, u shpreh **gadishmëria për përfshirjen e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në takimet periodike të Mekanizmin e Koordinuar të Referimit** (*ngritur nga Bashkia Tiranë në zbatim të ligjit nr.9669/2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”*).

Gjithashtu, përfaqësues të Bashkisë së Tiranë, shprehën dakordësinë për **zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse në 6 Qendrat Multidisiplinare Komunitare**, ku ofrohen shërbime sociale të integruara për grupet vulnerabël, përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Në vijimësi, u dakordësua hartimi i një **kaledari të përbashkët periodik për zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse**.

2.5 Vijnë bashkëpunimi i frytshëm Ministrisë së Drejtësisë/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) për sigurimin e shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti

Ministria e Drejtësisë/ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas nënshkroi me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), marrëveshjen mbi zbatimin e projektit “*Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri*”.

Referuar kësaj marrëveshje sigurohet ofrimi i pandërprerë i shërbimeve të ndihmës juridike falas në 8 (tetë) qendrat ekzisutese të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës, Fier, Lezhë, Vlorë, Dibër, Gjirokastrë, Pogradec dhe Shkodër duke fuqizuar më tej aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël.

Falënderojmë Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), për mbështetjen dhe ftojmë të gjithë qytetarët të paraqiten pranë Qendrave për të përfituar shërbime juridike falas!

2.6 Takim në qytetin e Pogradecit

Në mbështetje të Marrëveshjes Standarde mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrisë së Drejtësisë mbi zbatimin e Projektit “*Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri*”, më datë 20.09.2021 u zhvillua një tryezë diskutimi në qytetin e Pogradecit midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, punonjëseve të

Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec dhe aktorëve të tjerë që operojnë në qytetin e Pogradecit.

Ekipi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas diskutoi në detaje mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, rolin e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit me aktorët kryesorë.

Gjatë këtij takimi u diskutuan mbi problematikat e hasura nga përfaqësuesit dhe u dakordësua mbi referimin e rasteve pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec.

3. FUSHATA NDËRGJEGJËSIMI

3.1 Aktivitet ndërgjegjësues pranë Qendrës Sociale Multidisiplinare

Më datë 20.10. 2021 pranë Qendrës Sociale Multidisiplinare u zhvillua aktiviteti ndërgjegjësues me shoqatën” Shpresë për të Verbërit”

Gjatë këtij aktiviteti u informua për shërbimet që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ofron për kategoritë në nevojë.

U vu re, se gjatë diskutimit disa nga qytetarët shprehën nevojat e tyre të cilat u mbajtën shënim për t’u referuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë.

3.2 Takim “Situata e Romëve në Bashkinë Lushnje”

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnje në bashkëpunim me Shoqatën e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, Lushnje zhvilluan takimin me temë “*Situata e romëve në Bashkinë Lushnje*”.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi problematikat e këtij komuniteti, shtrirja gjeografike e tij si dhe problemet ligjore me të cilat haset më së shumti ky komunitet.

Nga ana e përfaqësuesve të Qendrës u diskutua mbi rrisitë e ligjit nr. 111/2017, “*Për Ndhmën Juridike të- garantuar nga Shteti*” si dhe roli i Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në ndihmë të këtij komuniteti.

Në takim u shpërndanë edhe broshurat sqaruese të hartuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për antarët e këtij komuniteti dhe për të gjithë pjesëmarrësit.

3.3 Takim i hapur pranë komunitetit rom dhe egjiptian në Gjirokastrë

U zhvillua në qytetin e Gjirokastrës një takim i hapur pranë komunitetit rom dhe egjiptian.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë takuan nga afër qytetarë të komunitetit rom dhe egjiptian duke bashkëbiseduar nga afër për të dëgjuar problematikat kryesore që shqetësojnë këtë komunitet.

Nga ana e përfaqësuesve u fol mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, si alternativa më e mirë për zgjidhjen e problematikave të këtij komuniteti.

Ky takim rezultoi shumë frytdhënës, duke mbajtur shënim rastet dhe referimin e tyre pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë për të përfituar ndihmë juridike falas.

3.4 Aktivitet ndërgjegjësues pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Paraligjorët e angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë, po vijnë me zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse sipas kalendarit të aktiviteteve (*Korrik 2021-Prill 2022*).

Një ndër këto aktivitete ishte dhe aktiviteti i datës 31.08.2021, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të cilën Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit *“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas”*

Gjatë këtij aktiviteti, paraligjorët e angazhuar patën mundësinë të informojnë qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti; mënyrën e përfitimit të tyre si dhe vendndodhjen dhe kontaktet e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Drejtorisë e Ndihmës Juridike Falas.

Gjithashtu, në kuadër të ndërgjegjësimit të qytetarëve u vijua me shpërndarjen e fletëpalosjeve dhe afishimin e posterave *“Si të përfitojmë ndihmë juridike”* pranë ambienteve të kësaj gjykate.

3.5 Ndhima juridike falas në qytetin e Pogradecit

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve dhe vendosjen e posterave në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.

Paraligjorët e angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec zhvilluan një aktivitet ndërgjegjësues në qytetin e Pogradecit.

Gjatë këtij aktiviteti, paraligjorët e angazhuar patën mundësinë të informojnë qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti; mënyrën e përfitimit të tyre si dhe

vendndodhjen dhe kontaktet e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Drejtorisë e Ndihmës Juridike Falas.

4. TRAJNIME TË ZHVILLUARA PËR OFRUESIT E SHËRBIMIT

4.1 Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në rrethe

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas organizoi sot një takim me disa nga përfaqësuesit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore nëpër rrethe.

Në mbarëvajtje të punës, punonjësit e këtyre qendrave kanë të drejtë të kërkojnë informacione nga institucione të tjera dhe është e domosdoshme që të vulosin kërkesat e tyre, në këtë mënyrë të identifikohen si kërkues legjitimë.

Për këtë qëllim Drejtorja ndërmori hapa konkretë dhe ditën e sotme shpërndau të gjithë vulat zyrtare të miratuara.

Tashmë të gjitha Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore kanë vulat e tyre zyrtare.

Gjithashtu, në këtë takim Drejtori i Përgjithshëm diskutoi mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat që mund të hasin punonjësit.

4.2 Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë e cila më parë është financuar nga donatorë, tashmë me miratimin e Ministrit të Drejtësisë financohet nga buxheti i shtetit.

Kjo qendër ofron shërbime juridike falas për qytetarët çdo ditë pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë.

Qytetarët që përfitojnë janë ata në pamundësi financiare për të marrë një avokat, qoftë për t'u këshilluar, për t'u përfaqësuar në gjykatë apo për të përgatitur dokumentat për përfaqësim në gjykatë, apo për të ditur kujt t'i drejtohen.

Gjithashtu, shërbimet e ndihmës juridike falas ofrohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë për grupet vulnerabël / kategoritë e veçanta të ligjit si: gratë viktime të dhunës në familje, viktime të trafikimit, të miturit, grupet në nevojë, grupet që i përkasin komuniteteve apo pakicave kombëtare etj.

4.3 Trajnim i paraligjorëve të angazhuar

Në kuadër të konkretizimit të bashkëpunimit me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, referuar projektit: “*Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive*

vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, u mbyll me sukses sesioni i 4 (katër) trajnimeve të zhvilluara nga specialistët e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas mbylli me sukses trajnimet me certifikim për paraligjorët e angazhuar në kuadër të bashkëpunimit me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”.

Gjatë 4 ditëve u trajtuan këto tema:

- Ndhma juridike parësore;
- Ndhma juridike dytësore;
- Legjislacioni specifik për kategoritë e veçanta drejtëpërdrejtë përfituese të ligjit si dhe kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme;
- Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas gjen rastin të falenderojë pjesëmarrësit dhe Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”.

5. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

5.1 Marrëveshje Bashkëpunimi me Shoqatën “Invalidët E Punës Shqipëri”

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën “*Invalidët e Punës Shqipëri*”, shoqatë kjo e cila përfaqëson mbi 75 000 invalidë pune.

Në vijim të konkretizimit të bashkëpunimit me Shoqatën Invalidët e Punës Shqipëri, u zhvilluan takime midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Kryetarit të Degës së kësaj shoqate në qytetin e Fierit dhe Kryetarit të Degës në qytetin e Vlorës.

Nga ky takim pas shkëmbimit të kontakteve u vendos që kjo shoqatë do të referojë rastet pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier dhe Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë.

Kryetarët e degëve të kësaj Shoqate do të zhvillojnë takime të përbashkëta me antarët dhe punonjëset e Qendrave për të diskutuar nga afër mbi problematikat e kategorisë së invalidëve, kategori kjo e cila ka një vëmendje të shtuar nga ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

5.2 Bashkëpunim me Shoqatën Para-Tetraplegjikë, Dega Shkodër

Ekipi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas organizoi një takim informues me Shoqatën Para – Tetraplegjikë dega Shkodër. Ky takim u ndal në detaje në të problematikat që anëtarët e kësaj shoqate paraqitën. Përfaqësuesit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe punonjësit e Qendrës

së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër diskutuan mbi zgjidhjen e këtyre problematikave.

Në kuadër të konkretizimit të bashkëpunimit më këtë shoqatë, u nënshkrua marrëveshja e mirëkuptimit për të siguruar akses në drejtësi për të gjithë qytetarët.

5.3 Fokus i shtuar për kategoritë rome dhe egjiptiane përmes nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit me Organizatën “Drejtësi Sociale”

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, në cilësinë e institucionit publik që bën të mundur ofrimin dhe garantimin e shërbimeve ligjore falas kundrejt të gjithë qytetarëve në nevojë dhe kategorive të veçanta, i ka kushtuar një vëmendje të shtuar ofrimit të shërbimit ligjor falas për kategoritë më vulnerabël të shoqërisë siç janë komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

Përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Organizatën “*Drejtësi Sociale*” me nr. 13/1 prot., datë 17.01.2021, organizatë e dedikuar për mbrojtjen e të drejtave të kategorive Rome dhe Egjiptiane, palët marrin për sipër zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta të ndihmë të shtresave në nevojë.

Ofrimi i aksesit në drejtësi për kategoritë Rome dhe Egjiptiane është një ndër masat kryesore nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në ***Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve***

Në këtë kuadër, më datë **26.08.2021**, u zhvillua takimi vijues me përfaqësuesit e kësaj Organizate gjatë së cilit u dakordësua mbi aktivitetet e planifikuara për tu zhvilluar përgjatë gjashtë muorit të dytë të vitit 2021.

6. REGJISTRIMI I MARKËS SË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas si një institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë ka për mision garantimin e ndihmës juridike si një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që duhet të ketë çdo individ për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale mbi regjistrimin e logos së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas..

Pas përfundimit me sukses të procedurës së regjistrimit, Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale me anë të çertififikatës nr, 277/7 Prot datë 26.10.2021 regjistroi për një periudhë 10 vjeçare markën e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

7. MONITORIMI I VAZHDUESHËM

Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Pogradec

Në zbatim të Urdhrit Nr. 101, datë 02.09.2021, të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas “*Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin Cilësisë së Shërbimit të Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Pogradec*”, nëpunësi i caktuar me datë 20.09.2021 ka ushtruar kontroll të cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Pogradec.

Kontrolli nga mbikëqyrësi u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “*Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike*”.

Drejtorja e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike në kuadër të vlerësimit të cilësisë të shërbimit të ndihmës juridike parësore, ka analizuar me kujdes veprimtarinë e kryer nga punonjësit e qendrës sipas të gjithë indikatorëve të përcaktuar në dokumentin e metodologjisë së miratuar për këtë qëllim dhe ka vijuar me gjetjet, konstatimet, analizë të detajuar sipas anekseve respektive të metodologjisë me qëllim përcjelljen rekomandimeve drejtuar qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore Pogradec.

Në shtojcën bashkëlidhur paraqiten në mënyrë tabelare aktivitetet e zhvilluara përgjatë këtyre dy muajve.

SHTOJCË NR. 1

AKTIVITETET / TAKIMET E ZHVILLUARA

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Shtator – Tetor 2021

AKTIVITETET / TAKIMET E ZHVILLUARA TË DNJF <i>Publikuar në faqen zyrtare Ëeb si dhe rrjetet sociale të Facebook dhe Instagram</i>		
Nr.	AKTIVITETI I PUBLIKUAR <i>(takime / fushata ndërgjegjësimi / trajnime/ institucione bashkëpunuese)</i>	Në fokus të aktivitetit:
1	Takim me përfaqësuesit e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri	Me fokus mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe u bisedua mbi mundësitë e bashkëpunimit në funksion të promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes bashkëpunimit.
2	Takim në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit	Diskutim në terma teknikë mbi përmbajtjen e raportit të monitorimit për gjashtëmujorin e parë të vitit.
3	Takim me institucionet shtetërore në qytetin e Shkodrës	Diskutim mbi Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër, veprimtarinë e kësaj qendre dhe rezultatet e arritura deri tani
4	Takim me institucionet shtetërore në qytetin e Lezhës	Ky takim kishte në vëmendje rezultatet e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë dhe bashkëpunimin me aktorët e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.
5	Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore Gjirokastër, pranë Bashkisë Gjirokastër	Në takim u diskutua mbi vendosjen e urave të bashkëpunimit ndër-institucional, mbi rezultatet e bashkëpunimit të këtij institucioni me Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër dhe u dakordësua referimi i rasteve për ndihmë juridike pranë Qendrës

6	Bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Mekanizmin e Koordinuar të Referimit Kundër Dhunës në Familje me qëllim zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta	Me qëllimin kryesor ngritjen e urave të bashkëpunimit.
7	Vijon bashkëpunimi i frytshëm Ministrisë së Drejtësisë/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) për sigurimin e shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti	Referuar kësaj marrëveshje sigurohet ofrimi i pandërprerë i shërbimeve të ndihmës juridike falas në 8 (tetë) qendrat ekzisutese të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës, Fier, Lezhë, Vlorë, Dibër, Gjirokastrë, Pogradec dhe Shkodër duke fuqizuar më tej aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël
8	Takim në qytetin e Pogradecit	Zvillim i një tryeze diskutimi në qytetin e Pogradecit midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, punonjëseve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec dhe aktorëve të tjerë që operojnë në qytetin e Pogradecit.
9	Aktivitet ndërgjegjësues pranë Qendrës Sociale Multidisiplinare	Informim për shërbimet që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ofron për kategoritë në nevojë.
10	Takim “Situata e Romëve në Bashkinë Lushnje	Informim për shërbimet që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ofron për kategoritë në nevojë.
11	Takim i hapur pranë komunitetit rom dhe egjiptian në Gjirokastrë	Nga ana e përfaqësuesve u fol mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, si alternativa më e mirë për zgjidhjen e problematikave të këtij komuniteti. Ky takim rezultoi shumë frytdhënës, duke mbajtur shënim rastet dhe referimin e tyre pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë për të përfituar ndihmë juridike falas.
12	Aktivitet ndërgjegjësues pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	Gjatë këtij aktiviteti, paraligjorët e angazhuar patën mundësinë të informojnë qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti; mënyrën e përfitimit të tyre si dhe vendndodhjen dhe kontaktet e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Drejtorisë e Ndihmës Juridike Falas

13	Ndihma juridike falas në qytetin e Pogradecit	Gjatë këtij aktiviteti, paraligjorët e angazhuar patën mundësinë të informojnë qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti; mënyrën e përfitimit të tyre si dhe vendndodhjen dhe kontaktet e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Drejtorisë e Ndihmës Juridike Falas.
14	Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në rrethe	Në mbarëvajtje të punës, punonjësit e këtyre qendrave kanë të drejtë të kërkojnë informacione nga institucione të tjera dhe është e domosdoshme që të vulosin kërkesat e tyre, në këtë mënyrë të identifikohen si kërkuar legjitimë
15	Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë	Informacion mbi funksionimin e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë, tashmë financuar nga buxheti i shtetit
16	Trajnim i paraligjorëve të angazhuar	• Ndihma juridike parësore; • Ndihma juridike dytësore; • Legjislacioni specifik për kategoritë e veçanta drejtëpërdrejtë përfituese të ligjit si dhe kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme; Mbrotja e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane
17	Marrëveshje Bashkëpunimi me Shoqatën “Invalidët E Punës Shqipëri”	Në vijim të konkretizimit të bashkëpunimit me Shoqatën Invalidët e Punës Shqipëri, u zhvilluan takime midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Kryetarit të Degës së kësaj shoqate në qytetin e Fierit dhe Kryetarit të Degës në qytetin e Vlorës.
18	Bashkëpunim me Shoqatën Para-Tetraplegjikë, Dega Shkodër	Takim informues me Shoqatën Para – Tetraplegjikë dega Shkodër. Ky takim u ndal në detaje në të problematikat që anëtarët e kësaj shoqate paraqitën.
19	Fokus i shtuar për kategoritë rome dhe egjiptiane përmes nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit me Organizatën “Drejtësi Sociale”	Takimi me përfaqësuesit e kësaj Organizate gjatë së cilit u dakordësua mbi aktivitetet e planifikuara për tu

		zhvilluar përgjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021.
20	Regjitrimi i Markës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas	Pas përfundimit me sukses të procedurës së regjistrimit, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale me anë të çertififikatës nr, 277/7 Prot datë 26.10.2021 regjistroi për një periudhë 10 vjeçare markën e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.
21	Monitorimi i Vazhdueshëm, Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Pogradec	Kontrolli nga mbikëqyrësi u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.